

1.1 Modeli i Syllabusit

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Psikologji		
Titulli i lëndës:	Ndikime sociale në shëndet		
Niveli:	Master		
Statusilëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	3 + 2		
Vlera në kredi – ECTS:	7		
Koha / lokacioni:	Për t'u definuar		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Dashamir Bërxulli		
Detajet kontaktuese:	dashamir.berxulli@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Kjo lëndë do të vazhdojë temat e trajtuara në lëndën 'Psikologji e shëndetit'. Fokusi i saj do të jetë trajtimin specifik të sistemeve dhe faktorëve socialë në raport me shëndetin. Gjithashtu, ekzaminime të rëndësishme do t'u bëhen mjediseve të veçanta sociale dhe ndikimit të tyre në shëndet.		
Qëllimet e lëndës:			
	Qëllimi i kësaj lënde është njohja e marrëdhënieve të ndërlikuara të faktorëve socialë në raport me shëndetin. Gjithashtu, formimi i një qasjeje kritike në raport me marrëdhënien e faktorëve socialë me shëndetin me qëllim ndryshimin e situatës aktuale mund të konsiderohet qëllim i lëndës.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<ul style="list-style-type: none"> • Njohja nga studentët e rëndësisë së faktorëve socialë për shëndetin e njeriut; • Nxitja dhe udhëzimi e studentëve të mendojnë në mënyrë kritike për impaktin e mjedisit social, mjedisor, politik, ekonomik dhe arsimor në shëndetin e njerëzve; • Njohja nga studentët i modelit biopsikosocial në kuptimin e shëndetit dhe sëmundjeve; • Mësimi nga studentët i analizimit të sjelljeve, qëndrimeve dhe bindjeve të njerëzve në raport me shëndetin dhe gjendjet shëndetësore; • Formulimi i çështjeve të ndryshme problematike të politikave publike në raport me shëndetin e njerëzve. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			1
Ushtrime në teren			
Kollokiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim			6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			1
Projektet,prezantimet, etj.			2
Totali			175
Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërime 50%; Diskutim me studentët 20%; Diskutimet e studentëve mes vete 15% Konsultime mbi lëndën dhe mbi punimin seminarik 15% Përqindjet e dhëna më sipër janë të synuara dhe të përafërta; varësisht nga prirjet e studentëve dhe nga perceptimi i mësimdhënësit mbi mundësitë për të bërë një punë optimale, këto përqindje mund të pësojnë ndryshime të lehta.		
Metodat e vlerësimit:	Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 10% Ese kritike: 30% Provimi final: 60%		
Literatura			
Literatura bazë:	Marmot, M. & Wilkinson, R. (Eds.). (2003). <i>Social Determinants of Health: The Solid Facts</i> . 2nd Edition. WHO Europe		
Literatura shtesë:	Artikuj të përzgjedhur nga profesori i lëndës.		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Hyrje në lëndë: prezantimi i koncepteve themelore të përcaktuesve socialë të shëndetit		
Java e dytë:	Shëndeti dhe modelet e zhvillimit: përcaktues biologjikë të shëndetit dhe ndërveprimi me faktorë socialë		
Java e tretë:	Statusi socio-ekonomik dhe shëndeti		
Java e katërt:	Gjinia, orientimi seksual dhe shëndeti		
Java e pestë:	Teoritë sjellore mbi shëndetin		

<i>Java e gjashtë:</i>	Teoritë sjellore mbi shëndetin II
<i>Java e shtatë:</i>	Pabarazia në shëndet: gjinia dhe politikat ekonomike
<i>Java e tetë:</i>	Ndikimi në nivele grupore mbi shëndet: marrëdhëniet në çift
<i>Java e nëntë:</i>	Ndikimi në nivele grupore mbi shëndet: familja
<i>Java e dhjetë:</i>	Ndikimi në nivele grupore mbi shëndet: komuniteti
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ndikimi në nivele grupore në shëndet: shteti
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Procese sociale dhe ndikimi i tyre në shëndet: normat shoqërore
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Procese sociale dhe ndikimi i tyre në shëndet: influencat dhe kontrolli
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Përmbledhje
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantime

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Në përputhje me frymën dhe nenet përkatëse të statutit të UP-së.